

NEWSLETTER No.4

“BUILDING COMMUNITIES OF KNOWLEDGE FOR COMPETITIVE MSE-S”

Priority Axis 1. Entrepreneurship & Innovation – Sp. Objective 1.3 Territories of Knowledge,
Project No. 1848, Subsidy Contract No BMP1/1.3/1848/2019,
Interreg V-B “Balkan – Mediterranean 2014 – 2020”

NË KËTË NUMËR

- **Rëndësia e Trajnimit të sipërmarrësve dhe të rinjve.**
- **Prof. Asoc. Dr. Bajram MUÇAJ**
- **Dr. Tom Preku Ekspert i Jashtëm**
- **Prof. Asoc. Dr. Altin MUÇA**

Trajnimi i sipërmarrësve merr një rëndësi të veçantë në një vend si Shqipëria, ku ekonomia vazhdon të jetë në tranzicion dhe ende çdo vit një numër i konsiderueshëm biznesesh mbyllen dhe të tjerë biznese lindin.

Sipas INSTAT:

Në fund të tremujorit të dytë 2021, niveli i papunësisë për të rinjtë nga moshë 15 deri 29 është 19.9%.

Fondacioni ABC

NË MBËSHTETJE TË SIPËRMARRJES DHE TË RINJVE



NGA BAJRAM MUÇAJ

Profesor i Asociuar Doktor Shkencash

Trajnimi i sipërmarrësve dhe të rinjve në fusha të ndryshme vazhdon të mbetet një aspekt shumë i rëndësishëm në Shqipëri.

Kjo merr një rëndësi të veçantë në një vend si Shqipëria, ku ekonomia vazhdon të jetë në tranzicion dhe ende çdo vit një numër i konsiderueshëm biznesesh mbyllen dhe të tjerë biznese lindin.

Shqipëria ka një normë të lartë të lindjeve të bizneseve të reja krahasuar me vendet Evropiane. Statistikat tregojnë se në vitin 2017 (vit i fundit me të dhëna të përditësuara për të gjitha shtetet e BE-së) norma e lindjeve të bizneseve të reja ishte 23.1%. Ky tregues përlllogaritet si raport i bizneseve të reja të regjistruara në një vit ndaj numrit total të bizneseve aktive në një vend.

Por viti 2018 shënoi rënie dhe norma e lindjes së bizneseve të reja në 2018-n ishte 18.8%. Kjo do të thotë që ka një numër të lartë sipërmarrësish qoftë të rinj apo edhe me përvojë që kanë nevojë të përditësojnë njohuritë dhe të rrisin kapacitetet e tyre në lidhje me menaxhimin e sipërmarrjes.

Ndërsa trajnimi i të rinjve me aftësitë që kërkon tregu i punës është një domosdoshmëri në Shqipëri, ku shkalla e papunësisë mes të rinjve vazhdon të mbetet e lartë, ndërsa punëdhënësit nga ana tjetër përballen me vështirësi në gjetjen e fuqisë punëtore të kualifikuar.

Sipas INSTAT në fund të tremujorit të dytë 2021, niveli i papunësisë për të rinjtë nga moshë 15 deri 29 është në nivelin 19.9%.

Sfida më e madhe për të rinjtë paraqitet sidomos në periudhën e kalimit nga shkolla, e cilitdo niveli, në tregun e punës. Sigurisht që kjo lidhet me faktorë të ndryshëm, siç janë:

- përpjekjet e pamjaftueshme nga institucionet arsimore për përgatitjen e të rinjve me aftësitë e duhura në përputhje me nevojat e tregut të punës;
- mungesa e bashkëpunimit me institucionet qeveritare, sektorin privat dhe aktorëve të shoqërisë civile për të investuar në politika dhe programe si në drejtim të rritjes së aftësive të tyre dhe lehtësimit të informacionit mbi mundësitë e punësimit.

Dhe janë pikërisht niveli i arsimit, aftësitë e buta dhe profesionale të të rinjve dhe mungesa e mundësive të praktikës, çështjet kryesore sfiduese, të cilat duhet të adresohen.

Por ka edhe shumë faktorë të tjerë që kushtëzojnë në mënyra të ndryshme karrierën dhe zhvillimin personal të të rinjve, në varësi të zonës ku banojnë, si edhe në funksion të kontekstit social. Për shembull, është lehtësisht i kuptueshëm impakti që ka distanca gjeografike nga aktorët e tregut të punës – ndërmarrjet ose zyrat e punësimit - mbi evolucionin e karrierës tek të rinjtë në veçanti.

Në një vend si Shqipëria, të rinjtë kanë nevojë për rrugë alternative dhe të përshtatura me profilin e tyre për të ndërtuar plane karriere, për të ndjekur ëndrrat e tyre dhe për t'u futur në tregun e punës. Për të kompensuar të metat dhe keq-funksionimin e tregut të punës ata detyrohen të përdorin lidhjet farefisnore: familjen, kushërinjtë, shoqërinë. Për të rinjtë që vijnë nga zonat rurale dhe malore, si dhe për ata të rinj të zonave urbane që janë zhvendosur së fundmi në qytete me familjet e tyre, kostoja e një karriere të sukseshme bëhet kaq e lartë, saqë opsioni i emigrimit jashtë vendit bëhet për këto të rinj një alternativë interesante.

Sipas përfaqësuesve të biznesit, kjo lidhet me mungesën e perspektivës për të ardhmen nga dhe hendekun e madh midis përgatitjes arsimore dhe aftësive të kërkuara në tregun e punës. Mungesa e këtyre aftësive tregon se të rinjtë në vend nuk janë konkurrues në tregun e punës dhe nuk kanë kapacitetin e nevojshëm për t'u përshtatur me ndryshimin e tij të shpejtë.

Një problem tjetër është se nuk ka një orientim të rëndësishëm të nevojave të tregut të punës. Kjo veçanërisht mbetet për t'u analizuar në nivelin e orientimit të të rinjve në nivelin e arsimit universitar si dhe në atë të shkollimit profesional, që po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm në vend.

Duke qene se Shqipëria është një treg relativisht i vogël pune, orientimi drejt këtyre dy çështjeve është adekuat.

Ndaj, bazuar edhe në gjetjet e studimit që u krye në kuadër të projektit “Building communities of knowledge for competitive MSEs – skills4MSEs”, Fondacioni ABC ka kryer një sërë trajnimesh, në mënyrë që të kontribuojë në rritjen e aftësive të buta dhe profesionale të sipërmarrësve dhe të rinjve që sapo kanë hyrë apo kërkojnë të hyjnë në tregun e punës.

Një mundësi e tillë ofrohet jo vetëm për t'i pajisur pjesëmarrësit në trajnim me një sërë aftësish të nevojshme në fushën e biznesit, por edhe për t'i nxitur ata që të vendosin në praktikë idetë e tyre.

Ne besojmë se me këto trajnime sot, do të kemi nesër sipërmarrës më profesionistë në zhvillimin e biznesit të tyre, të aftë të kuptojnë tregun dhe të identifikojnë nevojat e tij, të aftë të marrin vendimin e duhur për ecurinë e biznesit dhe të mirëinformuar për aftësitë e duhura menaxheriale që duhet të posedojnë.

Gjithashtu shpresojmë që të rinjtë që do të trajnohen do të bëhen të aftë të për të nisur një biznes, dhe të përgatitur për sukses, që me idetë e tyre do të sjellin risi dhe zhvillim të mëtejshëm.



Dr. Tom Preku,
ekspert për hartimin
e moduleve të
trajnitimit, ndër të
tjera thekson:
Projekti “Building
Communities of
Knowledge for
competitive MSE-s”

është i një rëndësie të veçantë në kontekstin shqiptar, ndaj jam shumë i kënaqur që bashkëpunoj me Fondacionin ABC për hartimin e moduleve të trajnitimit, në kuadër të këtij projekti.

Sigurisht, baza për hartimin e këtyre moduleve është kërkimi i tregut dhe identifikimi i nevojave për trajnim, të cilat na orientuan drejt zhvillimit të moduleve. Ne zhvilluam 11 module trajnimi për të plotësuar nevojat prioritare të trajnitimit, siç janë: nevojat e aftësive të buta për trajnim, aftësitë e gjenerimit të ideve, planifikimi i biznesit, marketing, mënyra e adresimit të nevojave të financimit, etj.

Tregu shqiptar karakterizohet nga një forcë e re pune ku grupmosha 15 deri në 29 vjeç përbën rreth 23% të popullsisë apo rreth 40% të forcës së punës (INSTAT). Për këtë arsye, qasja e kësaj grupmoshe ndaj punës është tepër e rëndësishme për zhvillimin e vendit. Në këtë kuadër merr një rëndësi specifike edukimi dhe trajnimi i tyre me shkathtësitë dhe aftësitë e nevojshme që duhen apo kërkohen sot për të ndërmarrë sfidat për menaxhimin e një sipërmarrje.

Nevoja për të qenë i pajisur me njohuritë më të reja dhe për t'u përshtatur në situata të ndryshme duke qenë krijues dhe inovativ janë çështje, të cilat janë theksuar në të gjithë modulet e trajnitimit.

Do të doja të falenderoja Fondacionin ABC, i cili bën më të mirën për të plotësuar boshllëkun që është krijuar përsa i përket kapaciteteve profesionale në Shqipëri, duke mos i lënë ato të

zhvillohen në mënyrë të natyrshme dhe rastësore.

Krijimi i një platforme të të mësuarit online, i hapur për të gjithë ata që duan të zhvillohen më tej është një nga nismat më të mira, dhe uroj që nisma të tilla, edhe pse modeste të përkrahen edhe nga institucione të tjera në vend.



**Menaxheri i Projektit
Z. Altin Muça,**


thekson se Projekti ka një rëndësi të veçantë, për faktin se është fakt i njohur tashmë se aftësitë e sipërmarrësve dhe të rinjve nuk është thjesht një problem

ekonomik për ta dhe familjet e tyre, por është po aq edhe problem shoqëror.

Ne besojmë fort se edhe në një sistem me nivel të lartë të arsimit profesional, përsëri është e nevojshme të vazhdohet kualifikimi profesional dual i të rinjve, i cili gërsheton specifika të teorinë që mësohet në shkollë me praktikën. Thellimi dhe fuqizimi i trajnitimit për sipërmarrësit dhe të rinjtë në veçanti, do të jetë “leva e Arkimit”, që do të çojë në një nivel më të lartë sipërmarrjen dhe do të lehtësojë hyrjen e të rinjve në tregun e punës.

Qëllimi ynë nëpërmjet këtij projekti është që t'u japim mundësi sipërmarrësve si dhe të rinjve që duan të hyjnë në rrugën e biznesit dhe jo vetëm, të formohen profesionalisht dhe këto njohuri t'ju shërbejnë për t'u zhvilluar më tej apo për të kapërcyer hendekun e kalimit nga shkolla në tregun e punës. Sot në treg nuk konkurrohet më me kosto të ulët pune, por me shprehi të larta profesionale.

Pajisja e sipërmarrësve dhe të rinjve me njohuri me informacion bashkëkohor teoriko praktik është një aset i çmuar për ta për të qenë konkurrues në treg.



Dua të theksoj se në tërësinë e tyre, modulet e hartuara të trajnimit si pjesë integrale e projektit, përfaqësojnë modulet më të mira, të cilat bazohen në “terrenin” shqiptar. Gjithashtu, këto module janë afër praktikitetit dhe lidhen me nevojat e tregut të punës.

Duke vlerësuar të gjithë procesin e projektit, që nga identifikimi i nevojave për trajnim, dizenjimi i moduleve për t’u qasur në mënyrën më efektive me këto nevoja dhe hallkën e fundit të realizimit të trajnimeve, vlerësoj që ky proces ka qenë i mirëhartuar dhe ka realizuar një qasje efektive në tërësinë e tij.

Fondacioni ABC beson shumë se pas përfundimit të këtij projekti ambicioz, ku do të realizohen një sërë kursesh trajnimi dhe do të funksionojë platforma online, përfituesit do të kenë përfitimet e tyre: së pari, rritje të vetëbesimit në aftësitë e tyre të buta dhe profesionale. Së dyti, një fotografi të të gjitha veprimeve dhe lëvizjeve që duhet të bëhen për të hapur ndërmarrjen e tyre të biznesit të vogël dhe menaxhimin e tij.